

Bazuar në nenin 26 paragrafët 3 dhe 4 nenin 29 paragrafi 2 pika 7 të Ligjit për veprimtaritë komunale (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr.55/16, 74/16, 2/18, 66/19, 40/19 dhe 140/22) nenin 38 paragrafi 1 pika 24 e Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”,nr 2/18,34/19 dhe 38/20), nenin 58 paragrafi 1 pika 24 e Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi – Rregulloret e Komunës”, nr.48/19) neni 10 paragrafi 1 pika 6 e Vendimit për themelimin e Sh.p.k.-së Veprimtaritë Komunale (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi nr.18/17 dhe 48/18)Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në seancën e mbajtur 12.12.2023, solli

P Ë R F U N D I M I N

për miratimin e Raportit të punës së SH.P.K.-së “Veprimtaritë Komunale “ Ulqin për vitin 2022

Neni 1

Miratohet raporti i punës i SH.P.K.-së “Veprimtaritë Komunale” Ulqin për vitin 2022 i miratuar nga Bordi i Drejtorëve i evidentuar me numër 2287 datë 07.07.2023.

Neni 2

Ky përfundim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – Dispozitat komunale”.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

**Numri: 02-016/23-534/5
Ulqin, 12.12.2023.**

**KRYETARI
Ardijan Mavriq**